



K.K.D.M

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 46 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27 / 02 / 2025

**VENDIM**

Nr.05, date 27 /02 /2025

**NË LIDHJE ME KËRKESËN E AGJENCISE SË ZHVILLIMIT TE TERRITORIT (AZHT) PER VLERËSIMIN E PROJEKT ZBATIMIN TE STRUKTURAVE TË SHËRBIM, BANIM DHE HOTELERI NE RRUGËN "KRISTO LUARASI", TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Për Miratimin e Rregullores për Sigurine e Digave dhe Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) mori në shqyrtim kërkesën e AZHT për vlerësim të Projekt Propozimeve për ndertimin e strukturave të shërbim, hoteleri dhe banim në rrugën "Kristo Luarasi", Tiranë. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Të informoj Agjencinë e Zhvillimit të Territorit (AZHT) pranë Këshillit të Ministrave se bazuar në Ligjin Nr. 8681, date 02.11.2000 "Për Projektimin, ndertimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", Neni 4, KKDM miraton projekt –idetë dhe projekt zbatimet e digave të reja si dhe projektet e riparimit dhe përmirësimit të digave që janë në shfrytezim; Për rrjedhojë duke u bazuar në legjislacionin e mësipërm, KKDM nuk ka kompetenca ligjore të shqyrtojë projekte për struktura të shërbim, banin apo hoteleri që nuk janë pjesë e riparimeve apo përmirësimeve të digës së liqenit të Tiranës e cila aktualisht është në administrim nga Ndermarrja e UK Tirane dhe në pronësi të Bashkisë Tirane;
- 2- Të informoj Agjencinë e Zhvillimit të Territorit (AZHT) pranë Këshillit të Ministrave se ndertimi i ketyre strukturave në afërsi të digës së liqenit të Tiranës rrit rreziqet në rast të prishjes së mundshme të kesaj dige. Për rrjedhojë, KKDM do të kërkojë instalimin e një sistemi të alarmit bashkëkohor për lajmerim në kohë reale të rrezikut që mund të vij nga prurjet e mëdha të ujit apo prishjet e mundshme të digës, si dhe instalimin e një sistemi të monitorimit të digës me instrumenta sipas kërkesave të VKM Nr. 147, date 18.03.2004 "Për Sigurine e digave dhe dambave", neni 29, 30, 31 dhe 32. Gjithashtu, duke qenë se këto struktura janë në afërsi të digës së liqenit, nëse leja e Ndertimit miratohet nga Institucionet përkatëse, gjatë ndertimit të ketyre strukturave duhet të instalohen instrumenta të posaçëm për monitorimin dhe kontrollin e ujërave nëntokësore, uljeve apo levizjeve të mundshme në zonë si dhe të evidentimit të çdo problemi në kohë reale që lidhet me qëndrueshmërinë e digës. Ky monitorim duhet të kryhet jo vetëm nga Kontraktori i punimeve por edhe nga përfaqësuesi i Pronarit të digës (Bashkia Tirane).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- 3- **Ti kërktoj Pronarit të digës (Bashkise së Tiranës) dhe Administratorit të digës (Ndërmarrjes së UK Tirana)** qe, bazuar në Ligjin nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", dhe të VKM Nr. 147, date 18.03.2004 "Për miratimin e Rregullores për sigurine e digave dhe dambave", te marrin masa te vecanta per monitorim special me instrumenta te gjithë diges dhe zones poshte saj ne perputhje me kerkesat e legjislacionit ne fuqi.
- 4- Duke u nisur nga fakti se në zonën ku ndodhet i gjithë sistemi ekzistues i shkarkimit të prurjeve të medha nga liqeni artificial i Tiranës ka patur ndërhyrje të ndryshme ndër vite për shkak të zhvillimit urban të zones poshte diges, KKDM do të rikerkoj një zgjidhje të plote teknike në këtë sistem që fillon nga portat e shkarkimit në dige deri në vendin e shkarkimit në lumin e Lanes. Bazuar në planimetrine e objekteve të dorëzuara nga AZHT pranë KKDM ku tregohet se objektet prekin gjurmën e sistemit të shkarkimit ekzistues, Bashkia e Tiranës dhe Ndermarrja e UK Tirana duhet të marrin masat e duhura për gjetjet e zgjidhjeve teknike të plota për sistemin e shkarkimit të digës. Këto zgjidhje duhet të marrin në konsideratë kerkesat e Vendimit të KKDM Nr. 6, datë 21.02.2024.
- 5- **Pronari (Bashkia e Tiranës) ose shfrytëzuesi i digës së liqenit të Tiranës (UKT), duhet të paraqesin urgjentisht për miratim në KKDM projektin e zbatimit për zgjidhjen teknike të plote të rehabilitimit dhe ndërtimit të një sistemi shkarkimi eficient** për prurjet e medha të ujit duke përfshirë edhe devijimin e tij në këtë zonë. Sistemi i ri i shkarkimit duhet të projektohet duke marrë për bazë jo vetëm kushtet aktuale hidro-meteorologjike, zhvillimin demografik dhe urban të zones poshte digës por edhe kushtet e reja të shfrytëzimit dhe operimit të liqenit artificial të Tiranës. Ky projekt duhet të referohet kërkesave dhe standarteve teknike bashkekohore të rekomanduara nga ICOLD dhe të miratuara nga KKDM. Projekti duhet të marrë në konsideratë jo vetëm gjendjen ekzistuese të të gjithë sistemit të shkarkimit nga portat e shkarkimit deri në daljen e tij tek Lumi i Lanes, shkallen e rrezikut të digës të përcaktuar sipas udhëzimeve të KKDM por edhe sasinë e prurjeve të ujit që derdhen në këtë sistem në pjesën poshte diges, prurjet maksimale që vijnë në pellgun ujëmbledhës sipas kërkesave të klasifikimit të kësaj dige, ndryshimeve klimatike. Projekti duhet të jetë i shoqëruar me llogaritjet përkatëse hidraulike dhe konstruktive në lidhje me permasimin e elementeve kryesore të sistemit të shkarkimit dhe të bazohet në një investigim të plote të gjendjes së brendshme të linjes kryesore dhe kapacitetit percjelles të këtij sistemi deri në derdhjen e ujrave në lumin e Lanes. Gjate investigimit duhet të identifikohen edhe prurjet e ujrave të zeza dhe ujrave të bardha që derdhen në këtë linjë si dhe pusetat kryesore të saj. Bazuar në këtë investigim duhet të kryhet kontrolli i kapacitetit percjelles të këtij sistemi dhe të jepen konkluzionet përkatëse për ripërmasimin e linjës kryesore duke u bazuar edhe në Vendimin e KKDM Nr. 36, date 25.10.2023 për kontrollin e kapacitetit percjellës të sistemeve të shkarkimit në digat e mëdha sipas rrishtit të cili në rastin e kësaj dige është i lartë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- 6- **Pronari i digës (Bashkia Tirane) ose shfrytëzuesi i digës (UKT) duhet të hartojnë urgjentisht Planin e Shfrytëzimit, Operimit dhe Sigurisë së digës sipas legjislacionit në fuqi dhe kërkesave të shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 43, datë 21.11.2023.** Sic dihet liqeni artificial i Tiranës në kohën e ndërtimit të digës ishte parashikuar për tu përdorur jo vetëm si atraksion urban por edhe për qëllime ujëtare të zonës poshtë tij si dhe industrisë në zonën jugperendimore të qytetit të Tiranës. Aktualisht, Liqeni artificial i Tiranës ka vetëm funksionin e një atraksioni turistik dhe urban. Duke patur parasysh kushtet aktuale të zhvillimit të zonës, ndryshimet klimatike si dhe kushtet e reja të zhvillimit urban dhe demografik përreth liqenit dhe poshtë digës, është e domosdoshme dhe emergjente hartimi i Planit të shfrytëzimit, Operimit dhe Sigurisë së digës i cili duhet të miratohet në KKDM sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM të ndjekë procesin e zbatimit të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**PER KOMITETIN KOMBËTAR TE DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**